



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit



{Shkresë	03.08.2023
Nga:	ZPP GEZIM HAJDINI
PER:	Grup i Operatorëve Ekonomik Mendi - P SH.P.K.; NPN EUROING SH.P.K.; N.T. „Fer-Petroll; N.N.SH. WORLD MEDIUM:
Lenda :	VENDIM

Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik nr 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr 05/L-068 dhe ligjin nr 05/L-92 Ligji mbi Prokurimin publik ne Kosovë,përkatesisht neni 108/A pika 2 dhe neni 6 pika 1 e Rregullave për parashtrimin e kërkesave për Rishqyrtim per Vendim te Autoritetit Kontraktues , Zyra e Prokurimit në Drenas nxjerrë :

VENDIM

1.Refuzohet si e pabazuar kërkesat e operatorive ekonomik “Grup i Operatorëve Ekonomik Mendi - P SH.P.K.; NPN EUROING SH.P.K.; N.T. „Fer-Petroll; N.N.SH. WORLD MEDIUM:” kunder njoftimit per dhenje per projektin “Zgjerimi dhe ndertimi i sheshit Fehmi dhe Xheve LLadrovci Drenasit “ me nr 611-23-2223-5-1-1 si e pabazuar

OE ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim te AK me datën 31.07.2023 kunder njoftimit per dhenje dhe refuzohet si e pabazuar.

Argumentet e refuzimit te kërkeses per ri-shqyrtim jane si me poshte :

Në kërkesën për Ri-shqyrtim të prezentuar nga ana juaj , ju keni konstatuar B-42 – Arsyjet e eliminimit tuaj , por ju nuk keni dhenë argumente shtesë nese janë apo jo të qendrueshme . Në kërkesën për ri-shqyrtim ju vetem keni deklaruar që Autoriteti ka mund të kerkojë sqarime nese ka pasë paqartesi .

Por Autoriteti Kontraktues në rastin e juaj nuk ka mund të kerkojë sqarime shtesë (sipas LPP dhe RRUOP) pasi qe shumë kërkesa as nuk janë të prezenuar në dosjen e tenderit psh disa nga to janë : Lista e stafit – 60 % nga lideri (nuk janë ofruar numri I stafit në listë dhe nuk janë ofruar deshmitë për stafin) , po ashtu edhe disa paisje nuk janë paraqitur në listat e stafit dhe nuk janë paraqitur deshmitë , letra e bankës nuk e ka deshmuar që ka qasje të pakushtëzuar në kredi 60 % nga lideri , menaxherja e prezentuar nga ana e juaj nuk I ka sjellë diplomën e noterizuar por ka sjellë noterizim te noterizimit (pasi qe ju jeni “takuar” per nenshkrim te kontartes ne veper keni mundur te keni edhe dokumente sipas kërkeses se AK - pasi qe nenshkrimi ne kontarte dhe ne cv kane dallime te dukshem . Andaj njoftojmë operatorin qe ka paraqitur kërkesë për ri-shqyrtim në AK se B-42 është komplet validë dhe arsyjet e eliminimit janë të qendrueshme .

Sa i perketë pretendimeve për operatorin e rekomanduar për kontratë pretendimet e juaja janë të pabazuara sepse në kontratën e prezentuar shihën qartë vultat e noterit në të dy anet e kontratës .

Pretenimi i dytë është i pabazuar sepse për të gjitha marrëveshjet janë prezentuar marrveshjet e kerkuara .

Po ashtu kemi pranuar deklaratë nga një antarë i konzersiumit i cili deklaronë që nuk është me pjesë e ketijë grupi , deklarata është e dorzuar edhe ne E-prokurim .

Kunder ketij vendimi keni te drejt ankese ne Oshp ne afate prej 10 dite .

PËR: KOMUNA GLOGOC (ZYRA E PROKURIMIT)
NGA: N.N.SH.WORLD MEDIUM(BURIM ZABELAJ B.I)
DATA: 01.08.2023

NJOFTIM

I/e nderuar

Po ju shkruajm lidhur me projektin: **Zgjerimi dhe ndertimi i sheshit Fehmi dhe Xheve LLadrovci Drenas**, me numër të prokurimit: 611-23-2223-5-1-1.

Ne si kompani N.N.SH.WORLD MEDIUM kemi qenë ofertues në këtë projekt si antarë të konzorciumit: MENDI-P SH.P.K&NPN EURO ING SHPK&FER PETROL&N.N.SH.WORLD MEDIUM. Ne kemi ofruar çmimin më të lirë në këtë procedurë, mirëpo gjatë vlerësimit jemi eliminuar përshkak se janë gjetur shumë gabime në dosjen tonë, ku edhe jemi shpallë si konzorcium i pa përgjegjës. Duke parë vendimin e eliminimit, Ne e kemi analizuar vendimin, dosjen tonë që kemi ofertuar dhe kemi arritur në përfundim se Autoriteti Kontraktues ka pasur të drejtë që na ka eliminuar.

Meqenëse Ne jemi të eliminuar në këtë procedurë dhe përshkak të gabimeve tona, dhe është e pa mundur që të shpallemi fitues në këtë projekt ju informojmë se Ne si kompani:

N.N.SH.WORLD MEDIUM(Burim Zabelaj b.i) nuk jemi pjesë e asnjë Kërkese për Rishqyrtim apo ndonjë Ankese tjetër në ndonjë institucion tjetër përshkak se nuk duam që të jemi pengesë në procedura dhe implementim të këtij projekti kaq të rëndësishëm për Qytetin e Glogocit por edhe për qytetarët e këtij vendi.

Me Respekt.

N.N.SH. WORLD MEDIUM

